

Nga aktiviteti i Institutit Zviceran i studimeve shqiptare – ISAEAL

Instituti që angazhohet për inegrimit më të mirë të kombit tonë

GJENEVË, 21 PRILL ■ Në Zvicër jetojnë rreth 200 mijë shqiptarë me prejardhje nga vendeve të gadishullit Ilirik por shumica nga Kosova, por ka një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve janë nga Maqedonia, pastaj nga Kosova Lindore, nga Mali i Zi si dhe nga Shqipëria.

“Në Zvicër, institucione dhe shoqata të shumta tregojnë interesim për komunitetin shqiptar në një formë apo në një tjetër. Mirëpo, asnjëra prej tyre nuk e studion dhe nuk pasqyrojnë komunitetin shqiptar në tërësi. Kjo është arsyeja që me emrin Institutit Zviceran i Studimeve Shqiptare (ISEAL), formohet një fondacion, në bazë të nenit 80 të Kodit Civil Zviceran...” shpjegon për nacionalen “Bota sot” profesor Driton Kajtazi, mësues dhe ish-drejtuës i Shoqatës së studentëve në Zvicër si dhe autor i librit “Hënore e Zvicrës” (Antologji e letërsisë së Zvicrës franceze, në shqip) dhe i pjesës teatrale “Guri Ura” (l’Étranger d’ici). Aktet normative të ISEAL-it janë miratuar zyrtarisht nga anëtarët themelues më 8 dhjetor 2007 në Lozanë dhe janë pranuar nga autoritetet federale më 25 mars 2008. Selia e ISEAL-it është në Lozanë, ndërsa aktivitetet e tij do të zhvillohen në tërësinë e territorit helvetik. Fondacioni ISEAL ndjek qëllime me vlerë publike, duke përjashtuar çdo qëllim përfitimi. ISEAL-tashmë ka marrë kontakte premtuese me partnerë të numër të institucioneve dhe shoqatash, si në Zvicër ashtu edhe në Shqipëri dhe Kosovë.

Sipas drejtorit të ISEAL z.Driton Kajtazit, qëllimi i themelimit dhe funksionimit të Institu-



tit zviceran i studimeve shqiptare ISEAL është zhvillimi dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, integrimi i shqiptarëve në Zvicër, përkatësisht që ISAEAL të bëhet një partner i njohur prej autoriteteve të Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe të shërbejë si pikë referimi për vende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjet shqiptare. Para fillimit të veprimtarive të ISEAL-it, është themeluar një shoqatë e miqve të ISEAL-it: aA?ISEAL nga më tepër se 124 personalitete shqiptare, zvicerane dhe të kombeve të tjera. Kjo shoqatë do t’i ketë dyert të hapura për të gjitha e të gjithë personat që dëshirojnë të mbështesin ISEAL-in, por edhe të zhvillojnë aktivitete që shkojnë në drejtim të synimeve dhe qëllimeve të ISEAL-it.

Në gjirin e aA?ISEAL është themeluar një «Komitet i Nderit» i cili aktualisht numëron 12 (dymbëdhjetë) anëtarë të Nderit. ■ Nefail MALIQI